



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K2/A3-15 Prot.
Nr. Dok. 202502193/15

Tiranë 27/10/2025

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave për bashkërendimin e punës në mënyrë që të ekzekutohen sa më parë vendimet penale (rasti i të dënuarit me burgim A. S.)*

GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM DURRËS

PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DURRËS

Për dijeni:

MINISTRISË SË DREJTËSISË
Komisionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale
Tiranë

Të nderuar,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë përfaqësuesi ligjor i të dënuarit me burgim A. S., i cili pretendon se ky shtetas është mbajtur në paraburgim megjithëse ka plotësuar dënimin me 10 muaj burgim të dhënë për veprën penale “*Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale*”.

Përfaqësuesi ligjor i të burgosurit A. S. ka kërkuar që institucioni i Avokatit të Popullit të nisë një hetim administrativ lidhur me dinamikën e vuajtjes së dënimit për këtë shtetas.

Pasi u njohëm me këtë çështje, referuar nenit 13, paragrafi i parë, të Ligjit nr.8485, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: *“Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike”*, vlerësuam se ajo përmban elemente për t’u pranuar për shqyrtim nga ana e institucionit tonë.

Për verifikimin e kësaj ankese, fillimisht i kemi kërkuar IEVP Shkodër, ku ndërkohë ishte transferuar shtetasi A. S., të na vinte në dispozicion dokumentacion që ka të bëjë me dënimet penale të dhëna për këtë shtetas.

Referuar dokumentacionit që na është vënë në dispozicion rezulton se ndaj shtetasit A. S. janë dhënë tre dënime penale. Më konkretisht:

1. Me Vendimin nr. 1094, datë 09.04.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është deklaruar fajtor për veprën penale “Mashttrim”, e kryer në bashkëpunim dhe është dënuar me 8 vite burgim. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 19.05.2017.
2. Me Vendimin nr. 2101, datë 27.06.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “Heqja e paligjshme e lirisë”, e kryer në bashkëpunim dhe është dënuar me 2 vite burgim¹. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 19.07.2017. Vendimi nr. 2101, datë 27.06.2016 është kthyer për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me Vendimin nr. 1194, datë 16.05.2024 ka ndryshuar masën e dënimit nga 2 vjet në 2 vjet e 4 muaj.
3. Me Vendimin nr.11-2024-3526/552, datë 25.06.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiskionit të Përgjithshëm Durrës, është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale *“Futja dhe mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale”* dhe është dënuar me 10 muaj burgim. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 26.07.2024.

Për kryerjen e veprës penale *“Futja dhe mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale”*, ndaj shtetasit A. S. është caktuar masa e sigurimit personal “Arrest në burg”, me Vendimin nr. 880, datë 23.12.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Urdhri i ekzekutimit të vendimit të dënimit penal për këtë vepër ka dalë në datën 14.11.2024 dhe i është komunikuar IEVP Jordan Misja, me shkresën Nr. 1642 Prot. (A.B), datë 18.11.2024, megjithëse vendimi ka marrë formë të prerë në datën 26.07.2024 dhe dënimi ka qenë plotësuar ndërkohë, me qëndrimin në paraburgim. Shtetasi A. S. është transferuar nga IEVP “Jordan Misja”, Tiranë, në IEVP Shkodër në datën 05.12.2024.

¹ Ky dënim është bashkuar me dënimin e mëparshëm me 8 vite burgim, në një të vetëm prej 9 vite burgim, me Vendimin nr. 1270, datë 05.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, por dënimi i bashkuar është bërë i paekzekutueshëm pasi dënimi me 2 vite burgim është ndryshuar me Vendimin nr. 1194, datë 16.05.2024, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Sipas përlllogaritjeve që ka bërë IEVP Shkodër, shtetasi A. S. ka përfunduar vuajtjen e dënimit me 8 vite burgim, ka përfunduar edhe vuajtjen e dënimit me 10 muaj burgim dhe i ka mbetur për të vuajtur një pjesë e dënimit me 2 vite e 4 muaj burgim, duke rifilluar llogaritja nga data 26.07.2024. Gjithashtu, IEVP Shkodër na vë në dijeni se ky shtetas ndodhet në proces gjyqësor me objekt “Njohje aministie”, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Në vijim të shqyrtimit të kësaj ankese, kemi kërkuar informacion në Prokurorinë Durrës, mbi arsyen pse urdhri i ekzekutimit të vendimit penal nr.11-2024-3526/552, datë 25.06.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ka dalë dhe është komunikuar për ekzekutim, pothuaj 4 muaj pasi ka marrë formë të prerë vendimi.

Në përgjigjen që kemi marrë nga Prokuroria Durrës shpjegohet se, vendimi penal nr. 552, datë 25.06.2024, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, i cili ka marrë formë të prerë në datën 26.07.2025, i është komunikuar Prokurorisë në datën 27.09.2025. Urdhri i ekzekutimit të këtij vendimi penal është nxjerrë në datën 14.11.2024, për shkak se duhej të merrej informacion në lidhje me vendimet e gjykatës para këtij vendimi.

Për të arritur në një përfundim mbi zbatimin e afateve të ekzekutimit të Vendimit penal nr. 552, datë 25.06.2024, me shkresën tonë Nr. K2/A3-10 Prot., datë 17.06.2025, kemi kërkuar të marrim informacion në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nëse është ankimuar ky vendim, kur është arsyetuar ai dhe cila është arsyeja, që prokurorisë nuk i është dërguar vendimi i përmbledhur në zbatim të afatit të parashikuar në nenit 63, pika 1, shkronja “a”, të Ligji Nr.79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

Në përgjigjen që kemi marrë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me shkresën Nr.3905/1 Prot., datë 30.07.2025, infomohemi se:

“Dosja penale me nr. (11-2024-3526) 553 vendimi, datë 25.06.2024, sipas verifikimeve të kryera në regjistrin manual të dorëzimit të dosjeve është dorëzuar më datë 05.07.2024.

Menjëherë pas dorëzimit të saj, janë bërë komunikimet e vendimit të arsyetuar palëve përkatëse dhe konkretisht Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka marrë dijeni mbi vendimin e arsyetuar më datë 08.07.2024 (kjo sipas dëftesës së komunikimit drejtuar Prokurorisë).

Pas realizimit të rregullt të njoftimeve për palët në vendim, duke qenë se ndaj tij nuk ka pasur ankim nga asnjëra prej palëve, vendimi i mësipërm ka marrë formë të prerë më datë 26.07.2024.

Vendimi i formës së prerë i është përcjellë Prokurorisë më datë 27.09.2024 (duke marrë parasysh këtu periudhën e lejes vjetore për nëpunësit e Gjykatës dhe Prokurorisë)”.

Vlerësimi i Institucionit të Avokatit të Popullit

Nga sa parashtruam më lart rezulton se, Vendimi penal nr. 552, datë 25.06.2024, në ngarkim të shtetasit A. S., është ekzekutuar rreth 4 muaj pasi ka marrë formë të prerë.

Ligji Nr.79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” përcakton subjektet përgjegjëse për ekzekutimin e vendimit penal dhe afatet e veprimeve që këto subjekte duhet të kryejnë.

Më konkretisht, në nenin 23, pika 1 përcaktohet si më poshtë vijon:

“Vendimet me burgim, me marrjen formë të prerë, i dërgohen prokurorit nga gjykata sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj”.

Ndërsa, afatet e veprimeve të gjykatës, përcaktohen në nenin 63 të këtij ligji, ku parashikohet se:

“1. Veprimet për vënien në ekzekutim të vendimit penal kryhen menjëherë sapo të jenë plotësuar kushtet ligjore, por jo më vonë se brenda këtyre afateve:

- a) për vendimet që përmbajnë dënim me burgim dhe për të cilat nuk është ushtruar ankim, gjykata i dërgon prokurorit kopjen e vendimit të përmbledhur brenda 24 orëve nga e nesërmja e ditës që vendimi merr formë të prerë;**
- b) vendimet e përmbledhura, që përmbajnë dënime të tjera penale ose urdhërime të tjera, i dërgohen prokurorit nga gjykata jo më vonë se 3 ditë nga marrja formë të prerë”.**

Sipas detyrimit ligjor, prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë, pas administrimit të vendimit përmbledhës për dënimet me burgim, duhet të kryejë veprimet paraprake për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit (neni 64, shkronja “a” i Ligjit Nr.79/2020 parashikon se: **“Prokurori kryen veprimet paraprake dhe nxjerr urdhrin e ekzekutimit: a) për dënimet me burgim ose mjekim të detyrueshëm në institucionet mjekësore, me të paraburgosur, menjëherë pas marrjes së përmbledhjes së vendimit”**).

Nga praktika e ekzekutimit të vendimit penal të rastit në fjalë, konstatojmë se Vendimi penal nr. 552, datë 25.06.2024, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në ngarkim të shtetasit A. S., ka marrë formë të prerë në datën 26.07.2025, pasi nuk është ankimuar nga palët dhe i është njoftuar i arsyetuar Prokurorisë Durrës nga Gjykata, në datën 27.09.2025. Ndërsa, prokurori ekzekutimeve të vendimeve penale, në Prokurorinë Durrës, ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit në datën 14.11.2024, i cili i është dërguar për zbatim IEVP “Jordan Misja”, në datën 18.11.2024.

Pra, rezulton se procedura e ekzekutimit të vendimit penal me burgim ka zgjatur tej afateve ligjore dhe ndërkohë, shtetasi A. S. ka qëndruar në mjediset e paraburgimit.

Në këto rrethana, kur tashmë vendimi penal për shtetasin A. S. është ekzekutuar, çojmë se ky rast shërben për t'u përgjithësuar, duke sjellë në vëmendje të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në mënyrë që të adresohet marrja e masave për ekzekutimin sa më parë të vendimeve penale, për të shmangur cënimin e të drejtave të personave të dënuar me burgim.

Neni 6 “*E drejta për një proces të rregullt*”, i KEDNJ-së zë një vend të rëndësishëm në tërësinë e të drejtave që garanton kjo konventë. Një proces i rregullt ligjor në çështje civile dhe penale është një element bazë i parimit të shtetit të së drejtës.

Garancitë e parashikuara në nenin 6 të Konventës, zbatohen jo vetëm në proceset gjyqësore, por edhe në fazat që paraprijnë dhe pasojnë ato. Duke qenë një e drejtë kushtetuese², e drejta për një proces të rregullt ligjor e vendos organin procedues para detyrimit për të vepruar pa zvarritje, në mënyrë që vendimi penal të ekzekutohet sa më parë, në mënyrë që të mos cënohet të drejtat e të dënuarve me burgim.

Urdhri i ekzekutimit është akti procedural që nxjerr prokurori për vënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor penal dhe, ndër të tjera, përmban: llojin dhe masën e dënimit kryesor, kohëzgjatjen tërësore të kryerjes së dënimit si dhe lojin e sigurisë që duhet të ketë vendi i kryerjes së dënimit (neni 12, shkronja “c” dhe “d” e Ligjit Nr.79/2020 “*Për ekzekutimin e vendimeve penale*”).

Bazuar në përlllogaritjen e prokurorit dhe dinamikën e vuajtjes së dënimit, IEVP-ja liron të burgosurin kur ai plotëson dënimin. Kjo është edhe arsyeja e vendosjes së afateve procedurale të shpejta në Ligjin Nr.79/2020 “*Për ekzekutimin e vendimeve penale*” dhe në Kodin e Procedurës Penal³, për gjykatën dhe prokurorinë, që të bashkërendojnë veprimet e tyre për të ekzekutuar sa më parë një vendim penal. Mund të ndodhë, që shtetasi të ketë plotësuar dënimin, me kohën e qëndrimit në paraburgim. Gjithashtu, zvarritja e procedurës për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit të vendimit penal, cënon të drejtën e shtetasve për

² Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet se:

1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.
2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

³ Neni 384

1. Vendimi shpallet në seancë nga kryetari ose një anëtar i trupit gjykues me anë të leximit të dispozitivit.
2. Pas dispozitivit kryetari lexon vendimin e arsyetuar. **Arsyetimi i vendimit mund të jepet me shkrim edhe në mënyrë të përmblëdhur, duke treguar shkaqet kryesore mbi të cilat bazohet vendimi. Në këtë rast, gjykata u jep palëve në seancë vendimin e përmblëdhur me shkrim.**

t'u transferuar në një IEVP më afër vendbanimit të familjes si edhe për të përfituar nga amnistia, në ato raste kur duhet të shprehet prokuroria.

Në analizë të këtyre të dhënave, Avokati i Popullit sjell në vëmendje se angazhimi maksimal i strukturave përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e mekanizmave ligjorë, do të përmirësonte procesin e ekzekutimit të vendimeve penale, si një hallkë e rëndësishme e procesit të rregullt ligjor.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*.

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave për bashkërendimin e punës, në mënyrë që të ekzekutohen sa më parë vendimet penale.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Besnik DEDA

D.V